

VENDIM
Nr. 641, datë 31.7.2013

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE TË OBJEKTIT “TUNELI I NËNDETËSEVE” DHE TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TIJ, PJESË E PRONËS NR. 959, ME EMËRTIM “ISH-BRIGADA E NËNDETËSEVE”, PALERMO, HIMARË, PËR TA PËRDORUR PËR NGRITJEN E MUZEUT “PANORAMA E LUFTËS SË FTOHTË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 3 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 901 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të objektit “Tuneli i nëndetëseve” dhe të truallit funksional të tij, me sipërfaqe 15 859 (pesëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë) m², pjesë e pronës nr. 959, me emërtim “Ish-Brigada e Nëndetëseve”, me vendndodhje në Palermo, Himarë, për një periudhë 20-vjeçare, sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për ta përdorur për realizimin e projektit të Muzeut “Panorama e Luftës së Ftohtë”.

2. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të nxjerrin aktet e nevojshme për dhënien në përdorim të objekteve, duke përcaktuar detyrimet për secilin institucion dhe duke përcaktuar modalitetet e moscenimit të veprimtarisë së Forcave të Armatosura.

4. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha